



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2022:223040

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05485012

P.nr.679/2022

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin Xhemajl JUSUFI, me bashkëpunëtoren profesionale Arbenita DËRGUTI, në çështjen penale kundër të pandehurit N...H..., për shkak të veprës penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të Kodit 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (*tutje si: KPRK*), sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2066 (2022:0073426), të datës 28.10.2022, duke vendosur sipas nenit 441 paragrafi 4 lidhur me nenin 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, më datë 21.03.2024, jashtë seancës, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP.II.nr.2066/2022, të datës 28.10.2022, e parashtruar kundër të pandehurit: N...H... nga Mitrovica, i lindur me datë 01.03.1974, me numër personal, me adresë të vendbanimit Rr. "D.... e K....", për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së, për shkak të mos plotësimit dhe korigjimit të aktakuzës PP.II.nr.2066/2022 të datës 28.10.2022, nga ana e Prokurorisë së Shtetit.
- II. E dëmtuara, Kompania KEDS, Dega në Mitrovicë, me adresë Rr. "Afrim Zhitia", nr.30, për realizimin e kërkesës pasurore – juridike, udhëzohet në kontest të rregullt civil.
- III. Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr. 2066/2022, të datës 28.10.2022, kundër të pandehurit N...H..., për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 të KPRK-së.

Gjyqtari vetëm gjykues, pasi e ka pranuar këtë lëndë, ka analizuar shkresat e saj dhe ka vërejtur se në rastin konkret Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm nuk ka arritur të marrë në pyetje të pandehurin para ngritjes së aktakuzës. Gjykata me datë 12.02.2024 i është drejtuar Prokurorisë me thirrje për plotësimin e parashtresës – aktit akuzues ashtu siç parashihet me dispozitat e nenit 149 paragrafi 1 të KPPK-së, të cilën parashtresë prokuroria e ka pranuar me datë 14.02.2024 dhe e njëjta nuk ka kthyer asnjë përgjigje.

Gjykata, pas vlerësimit të hollësishëm të shkresave të lëndës dhe mungesës së përgjigjes së prokurorisë në parashtresën e gjykatës për plotësimin e aktakuzës me marrjen në pyetje të pandehurit, ka vendosur për hedhjen e aktakuzës në këtë çështje, për faktin sepse nuk janë përmbushur kushtet ligjore për të vazhduar tutje lidhur me këtë lëndë, pasi që Prokuroria nuk ka arritur të sigurojë marrjen në pyetje të të pandehurit para ngritjes së aktakuzës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 149 paragrafi 1 të KPPK-së, ku shprehimisht është paraparë se: *“Përveç rasteve të parapara në nenin 234, paragrafi 2 të këtij Kodi, i pandehuri duhet të merret në pyetje nga prokurori i shtetit para ngritjes së aktakuzës. Nëse i pandehuri hetohet për veprë apo vepra penale për të cilat dënimi maksimal i paraparë është deri në tre (3) vjet burgim, mjafton që i dyshuari apo i pandehuri të jetë marrë në pyetje në polici me autorizim të prokurorit të shtetit”*. Në rastin konkret gjykata konstaton se vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri është e sanksionuar me dënim me gjobë ose burgim deri në tre (3) vite dhe është dispozitë imperative marrja në pyetje e të pandehurit para ngritjes së aktakuzës nga prokurori i shtetit ose nga ana e policisë, sipas autorizimit të prokurorit të shtetit.

Gjykata ka vendosur si në pikën një (I) të dispozitivit të këtij Aktvendimi dhe ka hedhur aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, pasi që sipas parashtresës së kësaj Gjykate, prokuroria është obliguar në plotësimin e aktakuzës me marrjen në pyetje të pandehurit, ashtu siç përcakton neni 149 i KPP-së, si dhe është paralajmëruar me pasojat në rast se nuk veprohet sipas parashtresës së Gjykatës. Neni 441 paragrafi 4 i KPP-së, përcakton se: *“4. Nëse me këtë Kod nuk është paraparë ndryshe, gjykata thërret paraqitësin e parashtresës së pakuptueshme ose që nuk përmban atë që është e nevojshme që të mund të veprohet në bazë të saj, që ta korrigjojë apo ta plotësojë parashtresën, e nëse ai nuk e bën këtë brenda afatit të caktuar, gjykata e hedh poshtë parashtresën.”* Andaj mbi këtë bazë, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Vendimin lidhur me udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata e ka vendosur në bazë të nenit 462 paragrafi 3 të KPP-së, ku është përcaktuar se: *“Kur gjykata merr aktgjykim me të cilin i pandehuri lirohet nga akuza ose me të cilin akuza refuzohet apo kur me aktvendim pushohet procedura penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta realizojë në kontest civil. Kur gjykata shpallet jo kompetente për procedurën penale, e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike ta ushtrojë në procedurë penale të filluar ose të vazhduar nga gjykata kompetente”*.

Në përputhje me nenin 453 paragrafi 1 të KPP-së, është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të ngelin në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Në bazë të nenit 441 paragrafi 4 e lidhur me nenin 357 paragrafi 1 nën par 1.3 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal
P.nr.679/2022, datë 21.03.2024

Gjyqtari
Xhemajl JUSUFI

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej tri (3) ditëve nga dita e pranimi të Aktvendimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët kundërshtare.